

GRUPI

**“EURON” shpk ,
Nipt:Njesia Mëmë: J71317002N**

SHËNIMET SHPJEGUESE

TE BILANCIT TE KONSOLIDUAR, TE SHOQERISE SE GRUPIT:

Euron shpk, Euron Energy shpk, Energal shpk.

(Per Pasqyrat Financiare te vitit ushtrimor 2021)

Sqarim:

Dhenia e shenimeve shpjeguese ne kete pjese eshte e detyrueshme sipas SKK2.
Plotesimi I te dhenave te kesaj pjese duhet te behet sipas kerkesave dhe struktura
Standarte te peraktuara ne ne SKK2 dhe konkretisht paragrafeve 49-55.

Radha e dhenies se shpjegimeve duhet te jetë :

- a- Informacion I pergjishem dhe politikat kontabel.
- b- Shenimet qe shpjegojne zerat e ndryshme te pasqyrave financiare.
- c- Shenime te tjera shpjeguese

Ky bilanc i konsoliduar dhe pasqyrat financiare te tij, i perket grupit te shoqerive te perbere nga :

- 1- **Euron shpk**, me nipt J71317002N , ne kete rast quhet , **Njesia mëmë**
me adresë : Komuna Farke , Selite, Pallati EURON 7 KT, hyrja 1, njesia 1. **Tirane**,
- 2- **Euron Energy shpk**,me nipt L57703202C, njesi ekonomike e kontrolluar 100%
nga **Njesia mëmë**.
me adresë : Kukes , Zapod Rruga Kukes-Shishtavec, Km.8, HC BELE 1.**Kukës**
- 3- **Energal shpk**,me nipt: L57703201R , njesi ekonomike e kontrolluar ne masen prej
88.68% nga **Njesia mëmë**.
me adresë : Kukes , Rruga Kukes-Orgjost, km. 10, HC Orgjost. **Kukës**.

Keto pasqyra jane hartuar ne perputhje me SKK, te permiresuara dhe konkretisht te SKK nr. 9 , si dhe ne zbatim te paragrafeve 49-55 te SKK2 si dhe ne zbatim te ligjit nr 9228 dt.29.04.04 “ Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare ”.

Njesite e kontrolluara jane perfshire ne pasqyrat financiare te konsoliduara , zë per zë.
Ne keto pasqyra financiare ,informacioni finanziar i njesise mëmë dhe i njesive te kontrolluara prej saj, eshte bashkuar si te jetë i nje njesie te vetme.

Pasqyrat financiare te konsoliduara perbehen nga :

- a- Bilanci i konsoliduar,
- b- Pasqyra e konsoliduar e te ardhurave dhe shpenzimeve ,
- c- Pasqyra e konsoliduar e fluksit te parase ,
- d- Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve ne kapital.

Per preqatitjen e pasqyrave financiare te konsoliduara , jane zbatuar te njejtat parime si per preqatitjen e pasqyrave financiare individuale , pervec faktit qe, i gjithe informacioni,ne lidhje me njesine mëmë dhe njesite e kontrolluara prej saj ,paraqitet sikur te ishte nje njesi e vetme ekonomike.



Te gjitha kerkesat per t'u arketuar dhe pasivet brenda grupit ,veprimet mes njesive te grupit si dhe fitimet dhe humbjet e pa realizuara , si rezultat i tyre , jane eliminuar plotesisht,me qellim evitim e mbivleresimit te aktiveve dhe detyrimeve.(SKK 14,26.d.)

Aktivi

Aktive monetare , ne fund te periudhes perbehen nga 748,191,246 leke ,me nje rritje prej 30,314,225 leke ne krahasim me fillimin e periudhes.

*Gjendja e zerit “ Kliente “ ne fund te periudhes eshte e barabarte me 68,678,527 leke dhe ne krahasim me fillimin e periudhes ka rritje ne vleren 46,209,687 leke.

“Debitore dhe kreditore te tjere “, paraqitet me saldo ne fund te periudhes prej 238,477,016 leke.

“Tatimi mbi fitimin “ dhe “TVSH “paraqitet me saldo prej zero leke. .

“Te drejta dhe detyrime ndaj ortakeve “ paraqitet me saldo ne vleren 59,954,882 lek dhe ne krahasim me fillimin e periudhes ka rritje prej 16,125,168 lek.

*Zeri “Instrumenta te tjera borxhi “ paraqitet me vlore 41,261,431 leke e cila perfaqeson garancine e vene ne banke per kredine e marre.

* Aktivet Afatgjata Materiale jane paraqitur ne bilanc me vleren kontabile te tyre ne daten 31.12.2021 ,sipas kerkesave te SKK. Klasifikimi i ketyre Aktiveve eshte bere ne tre kategori sipas natyres se tyre.

Pasivi

*Zeri “Te pagueshme ndaj furnitoreve “ paraqitet per vleren 64,415,298 lek dhe ka nje rritje ne krahasim me fillimin e periudhes prej 3,338,003leke.


*Zeri “ Detyrime per sig.shoq.dhe shendetsole “ ne vleren prej 974,099 lek ,paraqet detyrimin per derdhjen e kontributit te sigurimeve , e cila eshte paguar ne muajin janar te vitit pasues

*Zeri “Detyrimet tatimore per TAP (tatim mbi te ardhurat personale) paraqitet per vleren 939,599 lek ,e cila eshte paguar ne muajin janar te vitit pasues.

Detyrimet tatimore per tatim fitimi jane baras me 6,950,627 leke,
Detyrimet tatimore per tvsh, jane baras me 6,808,087 lek.

“Dividente per t'u paguar “ paraqitet me saldo kreditore prej 102,224,026 lek,dhe perben te drejten e ortakeve per te terhequr pjesen e fitimit (dividentin) ,per te cilin eshte paguar detyrimi tatimor perkates ne momentin e krijimit te tij.

“Debitore dhe kreditore te tjere “paraqitet me saldo kreditore prej 155,881,300 lek , dhe ,ne krahasim me fillimin e periudhes nuk ka pesuar ndryshim.



*Zeri “ Hua marrje afatgjata “ perfaqeson pjesen e kredise bankare te Grupit ne fund te periudhes , e cila eshte e pashlyer akoma per shumen 610,627,046 leke, dhe qe ka ulje ne krahasim me fillimin e periudhes prej 144,812,318ek.

*Kapitalet e Veta te shoqerise se Grupit , ne fund te periudhes ushtrimore jane baras me 2,096,114,926 lek. Ato kane pesuar rritje ne krahasim me gjendjen ne fillim , ne vlera te barabarte me 213,482,537 lek.

E barabarte kjo, me vleren e fitimit neto te realizuar gjate ketij vitit ushtrimor.

Interesat e pakices ne shoqerine Energal jane 11.32% , ose baras me 48,831,190 lek.
Pra kapitalet e veta neto te Grupit , jane baras me 2,047,283,736 leke.

Per shoqerine e Grupit
Administrator i shoqërise
Euron shpk (Njesia meme)
Kujtim Shpata

